

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6695
E premte, 2 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Përrurohet Abetarja
e përbashkët
Kosovë - Shqipëri, FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MË 1 SHTATOR NUK FILLON VITI I RI SHKOLLOR 2022/2023 FAQE 4-5

VAZHDON GREVA NË ARSIM, QEVERIA NUK I TUMIR KËRKESAT E MËSIMDHËNËSVE



Më 1 shtator nuk ka nisur viti i ri shkollor 2022/2023 në Kosovë pavarësisht se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka deklaruar se janë bërë të gjitha përgatitjet për një gjë të tillë. Nga 25 gushti mësimdhënësit, edukatorët në kopshte publike, punëtorët

e administratës publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës janë në grevë. Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga

KOSOVA DHE SERBIA FILLOJNË ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT FAQE 7



**PANAIRI I "OPEN BALKAN"
NË BEOGRAD, RAMA: KEMI
HUMBUR SHUMË KOHË DUKE
TREGUAR KUSH ËSHTË I PARI** FAQE 3

AKTUALE



**SERBIA I STËRVITË USHTARËT
PËRGJATË KUFIRIT ME KOSOVËN** F. 2

**PËRPARIM RAMA: SPITALI
I KRUEQYTETIT PO BËHET** F. 5

**NJË I VDEKUR DHE 64 RASTE TË
REJA ME COVID** F. 7

EKONOMI



**BORDI I AKP-SË VENDOSI
PËR SHITJEN E 32 ASETIVE TË
NDËRMARRJEVE SHOQËRORE** F. 8

**RRITET INFLACIONI NË ITALI, SHKON
8,4 PËR QIND** F. 8

SPORT



**SKUADRAT 'NDEZIN MOTORËT'
PËR EDICIONIN E RI** F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Serbia i stërvitë ushtarët përgjatë kufirit me Kosovën

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ministria e Mbrojtjes e Serbisë ka njoftuar se forcat e armatosura serbe po zhvillojnë një stërvitje ushtarake në Zonën e Sigurisë Tokësore, që gjendet përgjatë kufirit me Kosovën. “Stërvitja po kryhet me qëllim të mbajtjes së një shkalle të lartë të gatishmërisë luftarake të njësisë të angazhuara dhe aftësisë së tyre për të reaguar shpejt në rast nevojë, si dhe për të garantuar paqen dhe sigurinë përgjatë vijës administrative në Kosovë dhe Metohi”, tha Ministria serbe e Mbrojtjes më 31 gusht. Siç thuhet në njoftim, vëmendje e posaçme do t’u kushtohet “stërvitjeve të veprimeve luftarake në rast të ndonjë sulmi ndaj njësisë, si dhe taktikave, teknikave dhe procedurave që përdoren për të parandaluar kalime të paligjshme, aktivitete të grupeve ekstremiste dhe krimin e organizuar”. Po ashtu, Ministria e Mbrojtjes e Serbisë ka njoftuar se forcat e armatosura serbe, të dislokuara në Zonën e Sigurisë Tokësore, kryejnë stërvitje gjatë gjithë vitit si para dislokimit, por edhe për zbatimin e detyrave që kanë në

këtë zonë.

Kjo, sipas autoriteteve serbe të mbrojtjes, “siguron një nivel të lartë të aftësisë për t’u përgjigjur të gjitha sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve që bien në fushën e përgjegjësisë së tyre”. Këto stërvitje po zhvillohen në kohën kur nga 1 shtatori Serbia për herë të parë pas 11 vjetësh nuk do të lëshojë dokumente hyrje/daljeje për qytetarët e Kosovës, por do të lejojë që t’i përdorin letërnjoftimet e tyre. Njësoj do të veprojë edhe Kosova për shtetasit e Serbisë. Për këtë marrëveshje palët u morën vesh më 27 gusht pas ndërmjetësimit të diplomatëve nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Heqja e dokumenteve për hyrje/dalje pasoi përshkallëzimin e tensioneve midis dy shteteve, pasi serbët lokalë në veri ngritën barrikada për t’i kundërshtuar vendimet e Qeverisë së Kosovës për këto dokumente, por edhe për reregjistrimin e makinave. Më 1 shtator, po ashtu, nis afati dymujor për reregjistrimin e makinave që qarkullojnë në veri të Kosovës e që lëshohen nga Serbia.



Qeveria gjermane po përgatit një paketë të tretë lehtësuese



BERLIN, 1 SHTATOR - Qeveria e Gjermanisë do të miratojë së shpejti një pako të tretë ndihmash për lehtësimin e qytetarëve nga kriza aktuale. “Jemi duke punuar për një konstrukt të ri lehtësimesh të mëdha”, ka thënë kancelari Scholz para gazetarëve në Brandenburg, në Kështjellën Meseberg, ku ishte zhvilluar takimi këshillues mes tri partive të koalicionit. Ministri i Financave, Christian Lindner, i partisë liberale FDP, e quajti një “pako të fuqishme” dhe gjithëpërfshirëse. Ai ka thënë se do

të ketë mbështetje financiare për të disfavorizuarit. Por ministri shtoi se pakaja do të përmbajë edhe mekanizma që shmangin spekulimet me çmimet e energjisë. Me gjithë pyetjet e gazetarëve, as Lindner, as Scholz e as ministri i Energjisë Habeck, nga partia e të gjelbërve, nuk dhanë hollësi për masat që do të përmbajë pakaja e tretë. Ajo pritet të miratohet nga mesi i shtatorit. Nuk dihet as edhe se a do të përfshihet sërish bileta mujore e transportit publik prej vetëm 9 eurosh.

Ministri federal i Financave, Christian Lindner, ka thënë se po shqyrton aktualisht mundësinë e financimit të një bilete të tillë me çmim të reduktuar, por kërkoi që një pjesë e biletës të financohej edhe nga landet. Më 1 shtator skadon edhe subvencionimi i çmimit të karburantit. Qytetarët do të lehtësohen me një ndihmë financiare me nga 300 euro për çdo person që është në marrëdhënie pune, duke përfshirë edhe punët si studentë ose punët me orar minimal (minijob).

Putini nuk do të marrë pjesë në varrimin e Gorbachevit

MOSKË, 1 SHTATOR - Presidenti rus Vladimir Putin nuk do të marrë pjesë në varrimin e ish-liderit sovjetik Mikhail Gorbachev për shkak të agjendës së ngjeshur, tha Kremli më 1 shtator. “Ceremonia lamtumirëse dhe varrimi do të mbahen më 3 shtator por, fatkeqësisht, agjenda e ngjeshur nuk e lejon presidentin që të marrë pjesë”, u tha gazetarëve zëdhënësi i Kremliut, Dmitry Peskov. Peskovi tha se Putini ka bërë nderimet e tij për Gorbachevin në spital, ku ai vdiq të martën në moshën 91-vjeçare.

Në televizionin shtetëror rus u shfaqën pamje të Putinit duke vendosur një buqetë me trëndafila pranë arkivolit të Gorbachevit. Më pas, presidenti rus mbajti një minutë heshtje. Ceremonia e varrimit të Gorbachevit do të mbahet të shtunën në Sallën e Kolonave në Moskë, që historikisht është përdorur për ceremoni mortore të zyrtarëve të lartë, përfshirë edhe të Joseph Stalin më 1953. Pas ceremonisë, trupi i pajetë i Gorbachevit do të varroset në varrezën Novodeviçi në Moskë,

pranë varrit të gruas së tij, Raisa, e cila vdiq më 1999. Peskov tha se do të ketë “elemente të funeralit shtetëror” për Gorbachevin, përfshirë edhe Gardën e Nderit. Sipas tij, ceremonia mortore do të organizohet me ndihmën e shtetit. Gorbachev më 1985 mori udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik dhe ishte i njohur për afrimin e tij me Perëndimin. Ai ishte bërë sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste Sovjetike dhe de fakto lider i vendit në moshën 54-vjeçare.



Kosova dhe Serbia fillojnë zbatimin e marrëveshjes për dokumentet e identifikimit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Nga 1 shtatori qytetarët e Kosovës dhe Serbisë po e kalojnë kufirin ndërmjet dy vendeve me dokumente identifikimi, sipas marrëveshjes arritur më 27 gusht, me të cilin autoritetet serbe i dhanë fund lëshimit të dokumenteve për hyrje-dalje për shtetasit e Kosovës pas rreth 11 vjetësh, ndërsa Kosova hoqi dorë nga zbatimi i masave të ndërsjella për këtë çështje.

Autoritetet serbe kane vendosur njoftime në vendkalimet kufitare në të cilat thuhet se mundësimi i kalimit të kufirit me dokumente të identifikimit të lëshuara nga Kosova bëhet "për arsye kretësish praktike", që liria e lëvizjes të bëhet më e lehtë, bazuar në marrëveshjen për lëvizje të lirë, por kjo nuk e paragjkon statusin politik të Kosovës.

Dakordimi i së shtunës, më 27 gusht, pasoi një periudhë përpjekjesh diplomatike amerikane dhe evropiane për t'i shmangur tensionet në terren që shpërthyen më 31 korrik pas reagimeve serbe ndaj vendimit të qeverisë qendrore në Prishtinë që dokumentet e identifikimit dhe targat e makinave të lëshuara nga Serbia të mos vlejnin në territorin e Kosovës, një veprim që zbatohet nga Beogradi për qytetarët e Kosovës që udhëtojnë nëpër Serbi tash e rreth 11 vjet me radhë.

Qeveria e Kosovës me kërkesën amerikane vendosi ta shtyjë zbatimin e vendimeve deri më 1 shtator.

Nga sot rrjedh afati prej dy muajsh për konvertimin e targave të



makinave për qytetarët serbë që përdorin targa të lëshuara nga Serbia me akronimet e qyteteve të Kosovës të kohës së Jugosllavisë. Me vendimin e qeverisë përdoruesit e këtyre targave duhet t'i kthejnë në ato të Republikës së Kosovës RKS.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u bëri thirrje të enjten qytetarëve serbë në Kosovë që të shfrytëzojnë këtë periudhë për konvertimin e targave. "Targat e lëshuara nga Serbia PR, KM, PZ, GL, UR dhe PE janë trashëgimi e (Slobodan) Millosheviqit. Kjo trashëgimi është barrë që nuk do të duhej ta mbani ju. Përveç kësaj, ajo po synon t'ju mbajë në të kaluarën dhe të izoluar. Konvertimi në targa RKS eliminon

këtë barrë dhe ju siguron lëvizje të lirë, të papenguar dhe pa paragjime në gjithë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë kryeministri Kurti në një videomesazh në gjuhën serbe.

Vendimi kundërshtohet nga Beogradi. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha të dielën se Serbia arriti më të mirën e mundshme nga marrëveshja me Prishtinën për dokumentet e identifikimit. Duke i komentuar paralajmërimet e kryeministrit Kurti lidhur me targat e makinave, tha se "ai dëshiron konflikte dhe probleme të vazhdueshme".

Një përpjekje në shtatorin e vitit të kaluar për nxitjen e serbëve të Kosovës që t'i konvertojnë targat e makinave nxiti protesta në veri,

ndërsa bisedimet e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dështuan të sigurojnë një zgjidhje.

Tensionet u ringritën më 31 korrik pasi Qeveria e Kosovës njoftoi se vendimi për targat do të hyjë në fuqi më 1 shtator. Grupe protestuesish serbë bllokuan rrugët kryesore duke kundërshtuar vendimin. Qeveria e Kosovës vendosi shtyrjen e zbatimit të vendimit për dy muaj, me kërkesën e diplomacisë perëndimore dhe bllokadat u larguan nën vëzhgimin e trupave paqeruajtëse të NATO-s, që paralajmëruan se do të ndërhyjnë nëse "rrezikohet qëndrueshmëria".

Bashkimi Evropian shpreson që

palët do të arrijnë një pajtim rreth targave të makinave sipas marrëveshjeve të arritura më parë në bisedimet në Bruksel, të cilat synojnë të sigurojnë një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, që është kusht për integritet evropian.

Kosova shpalli pavarësinë e saj në shkurt të vitit 2008 me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe shumicës së vendeve perëndimore, por kundërshtohet nga Serbia e cila llogaritet në përkrahjen e Moskës dhe Pekinit.

Serbia është vendi i vetëm evropian që nuk i ka vënë sanksione Rusisë për agresionin e saj në Ukrainë.

Përurohët Abetarja e përbashkët Kosovë - Shqipëri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

GJAKOVË, 1 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrën e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, Evis Kushi dhe ministrën e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës, Arbërie Nagavci, kanë

përuar të enjten në Gjakovë Abetaren e përbashkët dhe unike.

Tani e tutje fëmijët anembanë viseve të banuara me shqiptarë do t'i mësojnë 36 shkronjat e alfabetit shqip me të njëjtën abetare. "Në ditë si këto duhet kujtuar puna e sakrificave të gjithë atdhetarëve, intelektualëve të

pathyeshëm, albanologëve të pakompromis, studiuesve, mësimdhënësve e kontribuuesve të pazezërësive e burrave, që në kohët më të vështira e ruajtën gjuhën tonë shqipe, pasurinë tonë të përbashkët. Jam i lumtur që sot kemi në duar këtë abetare, për të cilën u zotuar me marrëveshjen nga mbledhja e

përbashkët e dy qeverive tona në nëntor të vitit të kaluar", ka theksuar kryeministri Kurti, duke shtuar se udha e shkronjave që na ka sjellë deri këtu ka qenë e gjatë dhe e vështirë. "U qoftë e mbarë rruga e diturisë, e ky vit i ri shkollor, të gjithë nxënësve e nxënësve, që do të mësojnë nga ky libër", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës po punon në mbështetje të shqiptarëve kudo që janë, e këtë po e bëjnë në bashkërendim me Qeverinë e Shqipërisë. "Sepse vetëm bashkë, krah për krah me njëri-tjetrin, mund t'i shtyjme përpara interesat tona për zhvillim e përparim në çdo fushë", ka deklaruar Kurti.





MË 1 SHTATOR NUK FILLON VITI I RI SHKOLLOR 2022/2023

Vazhdon greva në arsim, qeveria nuk i tumir kërkesat e mësimdhënësve

Më 1 shtator nuk ka nisur viti i ri shkollor 2022/2023 në Kosovë pavarësisht se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka deklaruar se janë bërë të gjitha përgatitjet për një gjë të tillë. Nga 25 gushti mësimdhënësit, edukatorët në kopshte publike, punëtorët e administratës publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës janë në grevë. Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 1 shtator - Për shkak të grevës, në Kosovë më 1 shtator nuk ka nisur viti i ri shkollor 2022/2023 pavarësisht se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka deklaruar se janë bërë të gjitha përgatitjet për një gjë të tillë. Në grevë, përveç punëtorëve të arsimit, janë edhe shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës që nga 25 gushti. Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve drejtuar Qeverisë së Kosovës është ndarja e 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga. Më 1 shtator përfaqësuesit e Këshillit Grevist të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) kanë vizituar disa shkolla të cilat janë në grevë. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit në Kosovë (SBASHK),

Rahman Jasharaj, në një konferencë për medie ka thënë se greva është duke vazhduar në institucionet arsimore. "Ne nuk do të lëvizim asnjë milimetër, greva do të përfundojë kur thoni ju [mësimdhënës]. Greva do të përfundojë kur qeveria do t'i plotësojë kërkesat tona", ka deklaruar Jasharaj. Ai ka bërë me dije se kanë dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë kundër ministrit të Financave, Hekuran Murati. Kallëzimi është ngritur për shkak se Murati ka marrë vendim t'i ndalojë pagat për punëtorët që janë në grevë që nga 25 gushti. Më 31 gusht Murati bëri me dije se autoritetet kompetente kanë bërë ekzekutim të pjesshëm të pagave për muajin gusht për shkak se nuk është përditësuar me kohë lista e personelit që ka punuar deri në fund të muajit. Ai ka thënë se ky përditësim i listës së pagave është i nevojshëm pas grevës që kanë

nisur sindikalistët.

Kurti: Nuk mund të paguhen njerëzit për punën që nuk e bëjnë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten se sindikalistët që janë në grevë nuk mund të paguhen "për punën që nuk e bëjnë". Gjatë një ngjarjeje në Gjakovë, në ditën e përfundimit të abetares së përbashkët Kosovë - Shqipëri, Kurti ka folur për grevën e punonjësve të arsimit dhe të shërbyesve civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës, të cilët janë në grevë nga 25 gushti. "Njerëzit duhet të paguhen për punën që e bëjnë sipas meritës. Nuk duhet të paguhen për mospunë. Kjo është jo vetëm një çështje e ligjit, jo e qeverisë, por është një çështje e arsyes të shëndoshë njerëzore. Secili prej nesh jemi punëtorë, nuk jemi pronarë, paguhemi për punën", ka thënë Kurti.

Reagimi i Kurtit vjen një ditë pas njoftimit të bërë nga ministri i Financave, Hekuran Murati, që tha se autoritetet kompetente kanë bërë ekzekutim të pjesshëm të pagave për muajin gusht, për arsye se nuk është përditësuar me kohë lista e personelit që ka punuar deri në fund të muajit.

BSPK-ja: Ndërhyrja e qeverisë në rrjedhën e grevës është joligjore, grevistët janë të vendosur

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka njoftuar se greva e përgjithshme është duke u zhvilluar dhe është shtrirë në të gjitha nivelet e shkollave dhe në administratat komunale në gjithë vendin, pa probleme e plotësisht sipas rregullave dhe normave ligjore. Sipas një njoftimi për medie, thuhet se të punësuarit grevistë janë edhe më të vendosur në të drejtën e tyre e sidomos pas kërcënimeve aspak të mira dhe rrënuese për demokracinë. "Ndërhyrja e partnerit social - qeverisë - në rrjedhën e grevës është joligjore dhe këtë do të duhej ta dijë mirë partneri ynë social - qeveria. Është ligji ai që të

punësuarit grevist ia jep këtë të drejtë e cila nuk duhet t'i cenohet e as që mund t'i cenohet dhe as t'i merret nga askush, aq më pak nga partneri ynë social - qeveria, e cila e ka për detyrë t'i mbrojë dhe t'u dalë krah veprimeve ligjore duke e krijuar mjedisin e duhur dhe të shëndetshëm për funksionimin normal e ligjor të shoqërisë. Tërheqja nga greva nuk do të ndodhë e as që mund të ndodhë, se është joligjore dhe Ligji për Grevën e detyron të punësuarin të bëhet grevist e të hidhet në grevë", theksohet në njoftimin e BSPK-së, duke shtuar se është ligji ai i cili të punësuarin e detyron të përdorë dhe të organizojë grevën si mjetin e fundit të presionit sindikal sa herë që dështojnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit me mjete të tjera ligjore. "Dhe të punësuarit grevistë i shtjerrën të gjitha mjetet e presionit sindikal dhe gjatë këtij rrugëtimi edhe u shpërfillën dhe nuk u morën e nuk u pranuan seriozisht kërkesat e tyre të arsyeshme e ligjore. Dhe po ligji është ai që mund t'i thërrasë në tërheqje të punësuarit grevistë, dhe kjo arrihet vetëm atëherë kur partnerët socialë, këtë rast Qeveria dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ulen në tavolinën e dialogut social dhe e gjejnë

Panairi i "Open Balkan" në Beograd, Rama: Kemi humbur shumë kohë duke treguar kush është i pari

BEOGRAD, 1 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë Panairit të Verës të mbajtur në Beograd në kuadër të "Open Balkan", tha se vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bashkëpunojnë dhe jo të jenë armiq me njëri-tjetrin siç ka ndodhur prej shekujsh. Ai ka theksuar se "Open Balkan" është shumë më tepër sesa ekonomi, tregti apo politikë, duke theksuar se në thelb është një projekt paqeje e bashkëjetese, duke e quajtur Ballkanin një lagje të vogël në mes të Evropës. Rama ka thënë se kjo nismë është për t'u ardhur në ndihmë të gjithë

qytetarëve apo tregtarëve, duke shkëmbyer produkte dhe zgjeruar prodhimin. "Kemi humbur shumë kohë duke u përpjekur t'i tregojmë njëri-tjetrit se kush është i pari, ndërkohë që një gjë e kemi mësuar të gjithë, që asnjë prej nesh nuk do të shkojë diku tjetër, të gjitha vendet tona janë këtu për të qëndruar edhe pas nesh, edhe shumë e shumë vite pas nesh dhe zgjedhja jonë është shumë e thjeshtë, si të qëndrojmë këtu në këtë vend duke qenë të gjithë në të njëjtën lagje të Evropës, duke u përpjekur ta bëjmë më të gëzueshme, më të jetueshme apo paqësore, apo

duke hedhur gurë mbi tjegullat e njëri-tjetrit, duke i vënë flakën njëri-tjetrit siç kemi bërë prej shumë vitesh e shekujsh", ka thënë Rama, duke shtuar se edhe këtu në këtë panair të nivelit të lartë evropian, është e qartë që është më mirë kështu së bashku. "Sot duke vizituar këtë panair ku, përveç prodhuesve nga Serbia, Maqedonia e Veriut, janë edhe nga shumë vende të tjera, me shumë famë për prodhimin e verës, u kemi dhënë mundësi që jo vetëm të shkëmbejnë produkte apo zgjeruar prodhimin, u kemi mundësuar që tregtarëve të verës një treg të përbashkët, të cilëve do

t'u duhej një kohë e madhe. Këtu janë 22 prodhues nga Shqipëria, ndërsa në Shqipëri çdo vit rritet me 10 për qind sipërfaqja e vreshtave. Synojmë ta zhvillojmë në mënyrë të përvitshme duke e spostuar nga njëri kryeqytet në tjetrin", ka deklaruar Rama. Ai ka thënë se duhet çuar përpara këtë nismë që, sipas tij, u takon të gjithë atyre që transportojnë, ofrojnë shërbime dhe që zhvillojnë industrinë. "Ballkani i hapur është shumë më tepër sesa ekonomi, tregti dhe politikë. Pra është një projekt paqeje dhe bashkëjetese. Kjo lagje e vogël në mes të Evropës të mos vuajë më

shumë, por të bëhet vizion i të ardhmes për rininë tonë", ka thënë Rama.

Prodhuesit e verës në Ballkan u bënë bashkë për herë të parë gjatë ceremonisë së hapjes së Panairit të Verës të mbajtur në Beograd në kuadër të "Open Balkan".

Në këtë panair morën pjesë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski. Gjithashtu, të pranishëm ishin edhe ministrat e katër kabineteve qeveritare.



zgjidhen e duhur dhe rrugën e duhur për plotësimin e kërkesave të të punësuarve grevistë", është thënë në njoftimin e BSPK-së. Më tutje, BSPK-ja ka theksuar se si gjithëherë edhe tash është në pritje të hapjes së dialogut të mirëfilltë social midis Partnerëve Socialë ashtu si e do rregulli dhe si e thotë ligji.

PDK-ja: Qeveria Kurti i mbylli shkollat për fëmijët

Partia Demokratike e Kosovës në një konferencë për medie ka reaguar ashpër ndaj vendimit të qeverisë Kurti për t'i lënë nxënësit pa mësim dhe mësimdhënësit e shërbyesit civilë pa paga. Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha,

ka thënë se kryeministri Kurti, i cili dikur premtonte kthimin e trurit në Kosovë, sot po merr vendime pa tru, duke u shpallur luftë mësimdhënësve, sepse ai nuk do dialog social, por nënshtrim. "Albin Kurti, Hekuran Murati dhe Arbërie Nagavci sot i kanë lënë fëmijët e Kosovës pa shkuar në shkollë. Sot ishte dashur të ishte ditë feste në gjithë Kosovën, e sidomos për fëmijët që nisin klasën e parë e që shkëlqimin e syve të tyre sot nuk e panë as prindërit e tyre. Sepse Albin Kurti që dikur premtonte kthimin e trurit në Kosovë, sot po merr vendime pa tru. Albin Kurti u ka shpallur luftë mësimdhënësve duke i lënë pa paga sepse janë në grevë dhe duke e prekur kështu në themel mirëqenien e tyre edhe

ashtu solide e të rënduar", ka thënë ajo.

Hoxha ka theksuar se mësimdhënësit e Kosovës sot është dashur t'i kenë pagat edhe ashtu të pamjaftueshme në llogari për t'i mbuluar kreditë dhe shpenzimet elementare të mbijetesës, por ata po injorohen totalisht nga qeveria. "Pra, si ka mundësi që fokusi i kësaj qeverie është vetëm te nxënësit, ndërsa mësimdhënësit të përjashtuar nga harta e interesit institucional. Mbi 340 000 fëmijë sot janë jashtë bankave shkollore. Mbi 80 000 familje e kanë mirëqenien e rënduar për shkak të ndalesës së pagave të anëtarëve të tyre. Dhe ironia, në anën tjetër, është që ministrja Nagavci, sot, në vend se të ishte me mësimdhënës e

nxënës në ndonjë shkollë duke e festuar fillimin e vitit të ri shkollore, sot ajo promovon Abetaren e përbashkët me Shqipërinë në një ditë kur shkollat janë të mbyllura", ka thënë ajo.

Haradinaj: Ndal sa s'të kanë ndalë, o Albin Kurti!

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar në lidhje me këtë situatë të krijuar. Ai i është drejtuar kryeministrit Kurti që të ndalet sa nuk e kanë ndaluar. "Ndal sa s'të kanë ndalë, o Albin Kurti! Ku je tuj dashtë me e çu këtë vend, o Albin Kurti?! A je tu e pa që je duke e shkatërru me themell? Me çfarë të drejte ia ndalë pagat personelit arsimor? Me cilin ligj a

me cilën kushtetutë? Kush janë ata sejmënë trima që i kërcënojnë e i shantazhojnë mësuesit!? Kush ta ka dhanë atë të drejtë që në pikë të verës me e lanë popullin në terr! Pse e ke pengu ndërtimin e Kosovës së Re? Pse nuk i ke hap rrugë gazit për energji? Pse po i mban paret e popullit në arkën e shtetit e nuk po i rrit rrogat. A ta ka thanë dikush se njerëzit kanë fillu të vuajnë edhe për bukë?", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Lideri i AAK-së ka thënë se ky vend nuk është pronë e Kurtit. "Ti ke marrë votë me qeverisë vendin e jo me shkatërru atë. Hiq dorë nga kjo mënyrë e qeverisjes sa nuk është bërë vonë. Ktheju popullit, sepse po t'u kthy ai ty, do të përfundosh me turp. Ndal vetë e mos lejo të të ndalin!", ka shkruar Haradinaj.

Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë muajit gusht ka ngritur 20 aktakuza

GJAKOVË, 1 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë muajit gusht 2022 ka ngritur 20 aktakuza kundër 20 personave për veprën penale "Dhuna në

familje".

Po gjatë këtij muaji prokuroria ka bërë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj katërbëdhjetë personave të dyshuar si kryerës të kësaj

vepre penale, të cilat janë aprovuar nga gjykata kompetente. Ata gjenden në paraburgim dhe ndaj tyre është duke u zhvilluar procedura hetimore.

Prokuroria Themelore në Gjakovë është e angazhuar t'i kryejë me seriozitet të lartë të gjitha rastet, me prioritet të veçantë ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje.



Një hap para drejt përcaktimit të metodologjisë për zhvillimin e Qendrës Historike të Prishtinës

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Është bërë një hap para drejt përcaktimit të metodologjisë për ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prishtinës.

Grupi kryesor i punës ka diskutuar metodologjinë për studimin e fizibilitetit për Qendrën Historike të Prishtinës të propozuar nga eksperti italian i trashëgimisë kulturore, përfshirë aktivitetet e planifikuara në zbatim të saj dhe koordinimin për punën e përbashkët përpara.

Duke përfshirë të gjithë hisedarët dhe aktorët relevantë, fizibiliteti dhe plani i menaxhimit do ta përcaktojnë ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prishtinës, një zonë me vlerë të trashëgimisë për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme.

Ky studim do t'i analizojë fuqitë e ndryshimit nga aspektet kulturore, mjedisore dhe socio-ekonomike dhe do ta mundësojë mbrojtjen, përmirësimin dhe zhvillimin e koordinuar. Plani do t'i identifikojë qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrës dhe do të zhvillojë strategji dhe veprime inovative, gjithnjë duke u



bazuar në legjislaturën lokale e ndërkombëtare si dhe konventat dhe praktikat më të mira botërore.

Ky projekt financohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe zbatohet nga UN-Habitat-i në Kosovë përmes

Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës të financuar nga Qeveria e Suedisë dhe synon ta integrojë

trashëgiminë kulturore në planifikimin hapësinor për zhvillim të qëndrueshëm, të gjelbër dhe gjithëpërfshirës.

Ka filluar asfaltimi i rrugëve në fshatin Temeqinë të Malishevës



MALISHEVË, 1 SHTATOR - Kanë filluar punimet për asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Temeqinë të komunës së Malishevës. Punimet në këto rrugë të fshatit Temeqinë i ka parë nga afër edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Avdi Morina, ku është takuar edhe me banorët e këtij fshati, e të cilët i ka uruar për rregullimin e rrugëve si dhe është zotuar për realizimin e

të gjitha projekteve për infrastrukturën rrugore. "Juve banorë të Temeqinës ju uroj për rregullimin e rrugëve dhe ju siguroj se të gjitha projektet infrastrukturore, e sidomos rregullimi i rrugëve të planifikuara, do të realizohet, pavarësisht prej problemeve me të cilat përballen operatorët, për shkak të krizës së përgjithshme jo vetëm në

vendin tonë. Jemi duke u angazhuar maksimalisht që të gjitha projektet e planifikuara t'i përfundojmë", ka thënë drejtori Morina.

Ai ka bërë me dije se në Temeqinë po asfaltohen rreth 500 metra rrugë në lagjet e fshatit, të cilat lidhen me rrugët kryesore në fshat dhe asfaltimi i tyre mundësohet nga buxheti i komunës së Malishevës.

Përparim Rama: Spitali i kryeqytetit po bëhet

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me drejtorin Shëndetësisë, Izet Sadiku, kanë vizituar lokacionin për ndërtimin e

objektit të spitalit të kryeqytetit. Ai ka thënë se spitali i kryeqytetit po bëhet. "Janë duke u bërë të gjitha matjet dhe analizat e nevojshme për ta siguruar

mbarëvajtjen e procesit. Punimet për spitalin e kryeqytetit janë duke ecur sipas planit dhe presim që ndërtimi të fillojë gjatë vitit 2023", ka shkruar Rama në "Facebook".



Komuna e Skenderajt, e hapur për bashkëpunim me organizatat që ndihmojnë arsimin

SKENDERAJ, 1 SHTATOR - Komuna e Skenderajt do të jetë e hapur dhe bashkëpunuese gjithëherë ndaj organizatave që e ndihmojnë arsimin

nëpërmjet aktivitete edukativo-arsimore, duke e promovuar mendimin kritik te te rinjtë. Kështu ka thënë kryetari Fadil Nura. "Sot, me Dren Gashin nga Teach for

Kosova, nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi për projektin që do të implementohet në shkollat tona. Anëtarja e Kuvendit Komunal, Sala Jashari, do t'i

koordinojë aktivitetet e parapara të projektit, që ai të prodhojë rezultate pozitive te te rinjtë e Skenderajt", ka thënë Nura.



Në Tiranë dhe Shkup kërkohej drejtësi për 11 vjeçen e dhunuar

TRIANË, 1 SHTATOR - Në kryeqytetin e Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut, Tiranë dhe Shkup, është kërkuar drejtësi për vajzën 11 vjeçe e cila dyshohet se është dhunuar nga pesë persona më 27 gusht në Prishtinë.

Në këto dy qytete është protestuar edhe kundër rasteve të tjera të dhunës ndaj vajzave dhe grave. Në protesta janë dëgjuar thirrjet "Mos më prek", "Vajzat janë krenaria e një kombi", "Ndëshko përdhunuesit", "Jo do të thotë Jo", "Zero tolerancë ndaj dhunës", "Pedofilët në burg të përjetshëm", "Vajza nuk është pronë e askujt", "Unë bërtitja jo".

Në Tiranë disa janë dëgjuar duke bërtitur "pesë burra, shtatë orë, 11 vjeç".

Protestuesit kanë kërkuar ndryshime ligjore për të ndërmarrë masa të repta kundër dhunuesve, por edhe për publikimin e emrave të tyre në opinion. "Ne kërkojmë që shtetet t'i rrisin masat e mbrojtjes dhe sigurisë për vajzat dhe gratë dhe dënime më të ashpra kundër atyre që ushtrojnë forma të ndryshme të dhunës, legalizimin dhe shpërndarjen e gazit lotsjellës për vetëmbrojtje, regjistrin të pedofilëve, të respektohen konventat ndërkombëtare, me theks të veçantë ajo e Stambollit, trajnim të profesionistëve që punojnë me viktimat, rritje të ndërgjegjësimit për format e dhunës", ka thënë aktivistja Njomza Shaqiri në Shkup.

Protestuesit, gjithashtu, kërkuar shërbime të specializuara për



vajzat dhe gratë viktime të dhunës. "Dhuna kundër një vajze, dhuna kundër një gruaje, është dhunë kundër të gjitha vajzave dhe grave", thonë protestuesit.

"Apelojmë parandalimin e akteve të ngjashme në të ardhmen, duke vetëdijësuar popullatën me reagime të formave zyrtare dhe jozyrtare", ka thënë aktivistja Agnesa Çavolli në Shkup.

Autoritetet në Kosovë kanë caktuar

masën e paraburgimit prej 1 muaji për pesë të dyshuarit e kryerjes së dhunimit.

Shoqëria civile dhe shumë qytetarë kanë shprehur mlllef lidhur me këtë rast dhe më 30 e 31 gusht janë organizuar dy protesta në Prishtinë me kërkesa për mbrojtje të grave dhe luftim të dhunës ndaj tyre.

Të dhënat e Policisë së Kosovës tregojnë për dhjetëra raste të dhunës seksuale të raportuara çdo

vit.

Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, numri më i madh i viktimave të kësaj dhune janë vajza të moshës 13 deri në 16 vjeçe.

Kodi Penal i Kosovës parasheh dënime nga 2 deri në 15 vjet burgim për dhunime dhe sulme të tjera seksuale.

Raste të dhunës ndaj vajzave dhe grave janë regjistruar edhe në Maqedoninë e Veriut. Në regjistrin

e pedofilëve të Maqedonisë së Veriut janë të regjistruar 294 persona të dënuar për veprën penale "abuzim seksual të të miturve dhe pedofili".

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, këtë vit janë regjistruar dy raste të dhunës ndaj vajzave apo vepra të kryera kundër lirisë seksuale dhe moralit, ndërsa në tre vjetët e fundit për këtë veprë janë ndaluar 95 persona.



Shpërndahen çanta e mjete shkollore për 320 fëmijë në Gjilan



GJILAN, 1 SHTATOR - Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me "Shoqatën Islamic Relief Kosova", kanë shpërndarë të enjten çanta dhe mjete shkollore për 320 fëmijë të familjeve me asistencë sociale.

Kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka falënderuar "Shoqatën Islamic Relief Kosova" për mbështetjen dhe bashkëpunimin, duke shfaqur

shpresën se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Është një prej zotimeve tona që familjet me asistencë sociale, për fëmijët e tyre, ne si komunë do t'i mbulojmë shpenzimet me material shkollore dhe kjo pjesërisht po realizohet sot për shkak se prej klasave 1-5 po bëhet shpërndarja", ka thënë kryetari Hyseni.

Përfaqësuesi i "Islamic Relief

Kosova", Lavdim Gashi, ka deklaruar se kjo shoqatë për herë të parë po shpërndan çanta shkollore për fëmijët e familjeve me asistencë sociale, pas kërkesës së kreut të Gjilanit, Alban Hyseni. "E kemi realizuar projektin në bashkëfinancim me komunën e Gjilanit. Në të ardhmen do ta rrisim numrin në mënyrë që të mbulohej nevojat e fëmijëve të kësaj kategorie", ka thënë ai.

Një i vdekur dhe 64 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë shënuar 64 raste

të reja me Covid-19. MSh-ja ka njoftuar se është shënuar një rast i vdekjes nga Covid-19 në këtë periudhë

raportuese.

Po në 24 orët e fundit janë shënuar 363 persona, ndërsa në total numri i rasteve aktive

me Covid është 1 025. Të vaksinuar në këtë periudhë raportuese janë dymbëdhjetë.



Bordi i AKP-së vendosi për shitjen e 32 aseteve të ndërmarrjeve shoqërore

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka marrë vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor. Gjatë kësaj mbledhje bordi miratoi listën e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim për vendosje në tender publik përmes shitjes nr. 59, e cila ka gjithsej 32 asete. Gjithashtu,

shqyrtoi dhe miratoi transaksionet e shitjes me tender publik për valën SHAL 57 dhe tenderit publik për disa asete të luajtshme të ndërmarrjeve shoqërore. Bordi i AKP-së ka shqyrtuar edhe planin dinamik të punës së Komisionit të Banesave dhe si rezultat i shtimit të punës së Komisionit për shitjen e Banesave u miratuan raportet e shitjeve për 30 banesa. Bordi miratoi raportin e komisionit për shqyrtimin e

ankesave të listave të punëtorëve për 20 për qind të katër ndërmarrjeve shoqërore. Në këtë takim Bordi shqyrtoi dhe aprovoi raportin e komisionit për vlerësimin e performancës së menaxhmentit të AKP-së për periudhën gusht - dhjetor 2021. Gjatë kësaj mbledhje Bordi pranoi raportin me kërkesat e komunave për tërheqje të aseteve nga shitja sipas propozimeve të tyre për interes publik. Po ashtu, Bordi i AKP-së diskutoi

për raportin mujor për ndërmarrjen shoqërore "Brezovica", e cila është nën administrimin e AKP-së. Po ashtu, Bordi i Drejtorëve i AKP-së shqyrtoi dhe miratoi edhe disa rregullore të punës, përfshirë Rregulloren për qiradhënien e aseteve të NSh-ve dhe Rregulloren për përgjegjësitë e bordit të përkohshëm dhe drejtorit menaxhues të ndërmarrjes Shoqërore "Inex Sharr Planina", Brezovicë. Në vijim Bordi shqyrtoi dhe aprovoi

raportin gjashtëmujor për këtë vit mbi aktivitetet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Bordi shqyrtoi dhe miratoi edhe kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës për pëlqim/konfirmim për mospengim të zhvillimit të projektit në objektin e FFK-së. Më tutje, Bordi miratoi raportet e shpërndarjes për kreditorët e ndërmarrjeve shoqërore GJI097 NSh "N.T.Sh. Tregtia" dhe PRN078 Kombinati i Pambukut "YUMCO".



Rritet inflacioni në Itali, shkon 8,4 për qind



ROMË, 1 SHTATOR - Inflacioni në muajin gusht në Itali arriti në 8.4 për qind, më i larti që prej vitit 1985. Rekord shënoi e gjithë eurozona, ku inflacioni shkoi në 9,1 për qind. Vetëm për fluturimet, librat dhe kafenë italianët do të shpenzojnë 600 euro më shumë se një vit më parë. Duke filluar nga muaji shtator, kur shumica e familjeve italiane do të kthehen nga pushimet, do të gjejnë çmime jashtëzakonisht të larta. Edhe produktet ushqimore elementare do të pësojnë rritje domethënëse nga muaji shtator deri në muajin nëntor, ku një familje italiane do të shpenzojë rreth 155 euro më shumë se në të njëjtin periudhë të vitit të kaluar.

Edhe karburantet në Itali priten të rriten akoma, pasi është ende në fuqi vendimi për heqjen e akcizës, 30 centë për litër. Vendim është në fuqi deri në 20 shtator, por nuk dihet nëse do të vijojë të qëndrojë pas kësaj date, çka mund ta çojë një litër karburant mbi 2 euro. Rritja e çmimeve në Bashkimin Evropian vjen kryesisht për shkak të rritjes së çmimit të gazit që po arrin në 300 euro për megavatorë. Çmimi i gazit në Itali është rritur nga 461 euro në 588 euro me një diferencë prej 127 eurosh, që do përkthehet në fatura më të shtrenjta për fëmijët italianë dhe çmimi i faturave të energjisë elektrike do të rritet nga 200 euro mesatarisht në 2021 në 280 euro sivjet.

Shtesat për fëmijë, hapet aplikimi për të gjithë ata që kanë lindur në vitin 2012

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se shtesat për fëmijë do t'i përfitojnë edhe ata fëmijë që

kanë lindur në vitin 2012. Aplikimi për të përfituar nga këto shtesa është hapur të enjten. "Sot hapet aplikimi

edhe për fëmijët e lindur nga 1 janari i vitit 2012 që të përfitojnë nga shtesat për fëmijë", ka njoftuar Qeveria e

Kosovës. Aplikimi për Shtesa për Fëmijë tashmë do të jetë vazhdimisht i hapur në platformën eKosova.



A mund të largohet ndonjëherë Toka nga sistemi ynë diellor?



Nga Joe PHELAN

Në tregimin e shkurtër të Liu Cixin “Toka endacake”, botuar për herë të parë në revistën kineze “Science Fiction World” në korrikun e vitit 2000, Cixin portretizon një skenar në të cilin udhëheqësit e planetit bien dakord ta largojnë Tokën nga sistemi diellor, për t’i shpëtuar një shpërthimi të afërt të Diellit që pritet të shkatërrojë të gjithë planetët. Natyrisht kjo histori bazohet tek fanta-shkenca. Por a mund të largohet vërtet Toka ndonjëherë nga sistemi diellor? “Kjo gjë nuk ka gjasa të ndodhë”- thotë për Live Science Mateo Çerioti, inxhinier i hapësirës ajrore dhe pedagog i inxhinierisë së sistemeve hapësinore në Universitetin e Glasgout në Britani. Por sipas tij termi “nuk ka gjasa”, nuk do të thotë se është “e pamundur”. “Toka mund të largohet nga orbita e saj vetëm nëpërmjet veprimit të një objekti të madh ndëryjor, që fluturon nëpër hapësirën ndëryjore, dhe që vjen në sistemin tonë diellor duke kaluar pranë Tokës”- thotë ai.

“Në një skenar të tillë, Toka dhe objekti i madh qiellor do të shkëmbejnë energji dhe në moment orbita e Tokës do të ndryshonte. Nëse objekti do të ishte i shpejtë, i madh dhe mjaftueshëm afër, ai mund ta projektonte Tokën drejt një orbitë të drejtuar jashtë sistemit diellor”- shton eksperti.

Ndërkohë Timoti Dejvis, lektor i fizikës dhe astronomisë në Universitetin e Kardifit në Mbretërinë e Bashkuar, bie dakord se teorikisht Toka mund të nxirret nga sistemi diellor, dhe madje ka edhe hipotezën e tij se si mund të ndodhë kjo.

“Planetet, në formën që ekzistojnë sot, rrotullohen në orbita të qëndrueshme rreth Diellit.

Por nëse Dielli do të kishte një kontakt të afërt me një yll tjetër, atëherë ndërveprimet gravitacionale të këtyre trupave mund t’i tronditin këto orbita, dhe të bëjnë që Toka të nxirret nga sistemi diellor”- thotë Dejvis.

Por ndërsa ky skenar është i realizueshëm, Dejvis shton se është tepër e dyshimtë nëse do të ndodhë, të paktën në të ardhmen e parashikueshme. “Dukuri të tilla janë shumë të rralla,” tha Davis. “Për

shembull, ne e dimë që ylli “Gliese 710” pritet t’i afrohet Diellit brenda 1 milion vjetësh, por as kjo lëvizje nuk ka gjasa të shqetësojë planetët e sistemit”- thotë ai.

Pra ndërsa është e pamundur që forcat e jashtme ta detyrojnë Tokën të dalë nga sistemi diellor në një kohë të afërt, a mund të ndërtojë njerëzimi makineri të afta për ta zhvendosur planetin në një shkallë të tillë që të përfundojë duke ndryshuar orbitën?

“Energjia e nevojshme për të zhvendosur Tokën nga orbita e saj dhe për ta nxjerrë atë nga sistemi diellor është shumë e madhe, e barabartë me 1 sekstilion megaton (një 1 me 21 zero pas) bomba bërthamore që shpërthejnë menjëherë. Dhe kjo duket e pamundur”- thotë Dejvis.

Edhe pse një ngjarje e tillë nuk është aspak e mundur, çfarë do të ndodhte nëse Toka do të shpëruhej nga sistemi diellor? “Toka do të fluturonte në hapësirën ndëryjore derisa të kapej apo gëlltitej nga një yll tjetër apo një vrimë e zezë”- thotë Çerioti, duke shtuar se nëse Toka do të largohej nga sistemi diellor, kjo do të sillte shkatërrimin e shumicës dhe ndoshta të gjithë jetës në

planet.

“Nuk ka gjasa të vazhdojë të ekzistojë atmosfera. Klima globale e Tokës është shumë delikate për shkak të një ekuilibri të mirë të rrezatimit që vjen nga Dielli dhe energjisë së shpërndarë në hapësirën e thellë. Nëse do të ndryshonte, temperaturat do të ndryshonin menjëherë dhe në mënyrë dramatike”- thotë Çerioti.


Edhe Dejvis bie dakord që shumica e jetës në Tokë nuk do t’i mbijetonte largimit kataklizmik nga sistemi diellor. “Nëse Toka do të largohej nga sistemi diellor, ka shumë të ngjarë që do të zhdukej shumica dërrmuese e jetës siç e njohim ne. Gati e gjithë energjia e përdorur nga organizmat e gjallë të Tokës buron nga Dielli, ose drejtpërdrejt (bimët që bëjnë fotosintezën), apo indirekte (barngrënësit që hanë bimët, dhe mishngrënësit që hanë barngrënësit).

“Në këtë skenar, sa më shumë që Toka të largohej nga Dielli, aq më e ulët do të bëhej temperatura e saj. Në fund do të ngrinte plotësisht. I vetmi burim natyror i nxehtësisë, do të ishte prishja e elementeve radioaktive në koren e Tokës të mbetur nga formimi i sistemit

diellor.

Disa ekstremofilë (kafshë/bimë që mund të jetojnë në mjedise ekstreme) mund të mbijetojnë falë kësaj energjie, por jeta komplekse ka të ngjarë të zhduket plotësisht. Kjo nxehtësi radioaktive do t’i lejonte Tokës vetëm të kishte një temperaturë prej rreth minus 230 gradë. Në këto temperatura do të ngrinte pjesa më e madhe e atmosferës, duke e lënë Tokën si një botë të vdekur dhe të akullt që lëviz midis yjeve-shprehet Dejvis.

Duke parë larg në të ardhmen, Çerioti mendon se sistemi ynë diellor do të trazohet shqetësohet aq shumë, sa që Toka ose do të largohet prej tij, ose do të shkatërrohet tërësisht. “Ne parashikojmë se galaktika jonë është në rrugën e përplasjes me Andromedën, galaktikën tonë fqinje më të afërt pas afro 4.5 miliardë vjetësh. Një përplasje e tillë në shkallë të madhe të miliona yjeve, ka të ngjarë të shkaktojë një përçarje të madhe në sistemin diellor. Po ashtu parashikohet gjithashtu pas rreth 5 miliardë vitesh Dielli të bymeget dhe të gllabërojë Tokën”- thekson Çerioti. / “Live Science”- Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Skudrat 'ndezen motorët' për edicionin e ri



PRISHTINË, 1 SHTATOR - Edicioni i ri në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll po pritet me interesim të madh. Ky edicion do të fillojë më herët për shkak të pjesëmarrjes së skuadrave kosovare në garat ndërkombëtare. Kjo ka bërë që të gjitha skuadrat e elitës t'i fillojnë përgatitjet në fillim të muajit gusht dhe janë gati për edicionin e ri. Të gjitha skuadrat janë duke zhvilluar ndeshje miqësore, ndërsa garat e elitës do të fillojnë në fundjavën e ardhshme (10-11 shtator). Çdo xhiro do të ketë derbi, kurse këtë edicion Vëllaznimi është inkuadruar në elitë, në vend të Dritës dhe interesimi në Gjakovë

është i madh për basketboll, ashtu siç është edhe në Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Therandë dhe Rahovec.

Golden Eagle Ylli si kampion do të marrë pjesë në kualifikimet e Ligës së Kampionëve dhe nëse dështon në këtë garë, do të jetë në grupet e FIBA Europe Cup. Në garën e fundit, në kualifikime do të garojnë Trepça dhe Sigal Prishtina. Mitrovicasit pikërisht do të jenë mikpritës të grupit kualifikues më 27-30 shtator, kurse bardhekaltrit nëse nuk arrijnë të jenë në grupet e FIBA Europe Cup, do të garojnë në Ligën ENBL, për herë të parë në këtë garë. Po ashtu, skuadrat

kanë shprehur interesim edhe për Ligën Ballkanike. Transferimet gjatë afatit kalimtar "kanë ndezur" edhe më shumë rivalitetin në basketbollin e Kosovës. Dardan Berisha te Sigal Prishtina, Rodney Purvis dhe Arti Hajdari te Peja, Erjon Kastrati e Mikailë Tmusiq te Trepça, Malcolm Armstead te Golden Eagle Ylli, Meriton Ismaili te Ponte Prizreni dhe Fisnik Rugova e Altin Morina te Bashkimi, si dhe Vëllaznimi e Rahoveci me transferime vendore e të huaj, kanë bërë që të rritet interesimi për edicionin e ri, ndërsa shikuesit po e presin me padurim një superedicion dhe një supergarë në elitë.

SHKURT

FC Ferizaj transferon Borel Moukoko

Skuadra e Ferizajt e ka transferuar mbrojtësin Borel Moukoko, i cili është nga Kameruni, por me nënshtetësi gjermane. "Kemi kënaqësi t'ju informojmë se skuadra jonë është përforcuar me mbrojtësin e krahut të majtë, lojtarin nga Kameruni me nënshtetësi gjermane. Ai vjen në Kosovë pas disa përvajave në futbollin gjerman. Ne i dëshirojmë shumë suksese Moukokos me fanellën tonë", thuhet në njoftimin e skuadrës që drejtohet nga Arbnor Morina.

Gazmend Husaj vazhdon karrierën në Kuvajt

Volejbollisti i spikatur Gazmend Husaj ka vazhduar karrierën përtej kufijve evropianë, në Kuvajt, te klubi me të njëjtin emër, Kuvajt Club. Husaj, i cili është edhe anëtar i bordit të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), vazhdon karrierën në Kuvajt, pasi më herët kishte luajtur dhe kishte fituar shumë trofe në vende si Franca, Turqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Ai ishte volejbollisti me minutat më të shumta në ekipin nga Emiratet, Shabab Al Ahli, me të cilën fitoi ligën në mars të këtij viti. Po ashtu, ai ka qenë kapiten i Kombëtares së Shqipërisë dhe mbetet volejbollisti më i mirë nga Kosova i të gjitha kohëve.

Januzaj edhe zyrtarisht kalon te Sevilla

Adnan Januzaj do të vazhdojë të luajë në La Liga. Januzaj është lojtari i ri i Sevilës. Ai ka nënshkruar për katër vjet me ekipin nga Andaluzia. Transferimi u zyrtarizua nga vetë klubi spanjoll. Januzaj u largua nga Real Sociedad si lojtar i lirë, kurse në të kaluarën ka luajtur edhe për Manchester Unitedin dhe Borussia Dortmundin.

Festa e tepërt e Arsenalit ndaj Fulhamit, Xhaka: Keni respekt për çdo klub

Granit Xhaka u është kundërpërgjigjur disa komentuesve të cilët e kritikuan Arsenalin për "festimin e tepërt" kur fituan ndaj Fulhamit të shtunën, duke i këshilluar ata që të tregojnë pak respekt për klubin e Fulhamit. "Keni respekt për çdo klub! Nëse thonë se nuk mund të festojmë sepse ishte Fulham, ata nuk e respektojnë ekipin e Fulhamit. Ju i patë ata edhe të martën kundër Brightonit, ata fituan përsëri. Pra, jepini atyre një meritë, respektoni ata", ka thënë Xhaka. "Nëse nuk festojmë, ata na thonë 'Pse nuk po festoni?', nëse festojmë, ata thonë 'Pse po festoni?'. Kështu që ndonjëherë nuk mund t'i bëni të gjithë të lumtur. Kjo është puna jonë, kjo është ajo që ne duam të bëjmë. Ne festojmë nëse fitojmë, nuk ka rëndësi kundër kujt", ka shtuar Xhaka.

Dalin në shitje biletat për ndeshjen FC Ballkani - CFR Cluj

SUHAREKË, 1 SHTATOR - FC Ballkani ka bërë histori në futbollin e Kosovës. Do të takohet me skuadrën e famshme rumune, CFR Cluj, në Ligën e Konferencës. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin

"Fadil Vokrri" më 8 shtator, me fillim nga ora 18:45, ndërsa biletat kanë filluar të shiten. Biletat për këtë ndeshje do të shiten vetëm online sipas rregullave të UEFA-s, derisa një person mund t'i

blejë deri në gjashtë bileta. Tifozët e klubit "Xhebrailat" janë të vendosur në tribunën veri, kurse çmimet e biletave janë: veri dhe jug 5 euro, lindje 10 euro, perëndim 15 euro dhe VIP 50 euro.



Ferrari: Edhe Holanda e vështirë për ne, gomat po na penalizojnë

ZANDVOORT, 1 SHTATOR - Pas zhgënjimit fundjavën e kaluar në pistën belge të SPA-s, skuadra e Ferrarit përgatitet për një tjetër fundjavë të vështirë. Këtë herë garohet në pistën holandeze të Zandvoort, në shtëpinë e Max

Verstappenit, që do ta ketë mbështetjen e gjithë publikut. Mattia Binotto, drejtori sportiv i "kokëkuqes", është me këmbë në tokë dhe nuk pret ndonjë mrekulli në garën holandeze. "Karakteristikat e pistës bëjnë që

ajo të jetë shumë e ashpër për gomat dhe konsumi i tyre do të jetë i madh. Kjo është një pikë e dobët e jona", ka thënë Binotto. "Vështirë të mendosh për një haknarrje, ndaj duhet një makinë e balancuar. Duhet

gjetur një e mesme mes një makine që t'i menaxhojë mirë gomat, sidomos ato të përparmet dhe të jetë e shpejtë në kthesa. Një garë e vështirë për makinën dhe pilotët, të shohim", ka deklaruar Binotto.



Belotti: Kalimi te Roma ishte prioriteti im

ROME, 1 SHTATOR - Sulmuesi i Kombëtares së Italisë, Andrea Belotti, preferoi të kalonte te Roma, ndërsa tashmë është vënë nën urdhrat e trajnerit Jose Mourinho. Një kalim interesant për sulmuesin, i cili do të mundësojë ta bëjë maksimumin për t'i ndihmuar verdhekuqtë për arritjen e objektivave. Pikërisht është dita e prezantimit të tij përballë medieve si lojtar i Romës, në të cilën Belotti ka theksuar se te Roma ka gjetur një projekt ambicioz të udhëhequr nga Mourinho. "Kam kaluar një verë të çuditshme, në fakt e çuditshme ishte në përgjithësi për tregun e transferimeve. Ka shumë lojtarë që kanë mbetur të lirë për një kohë të gjatë. Prioriteti im ishte te vija në Romë sepse e di që kam gjetur një projekt të rëndësishëm, një ekip dhe një klub me ambicie të mëdha dhe kjo ishte ajo që më duhej. Nuk kërkoja një kontratë që do të më mbronte. Doja një projekt dhe një situatë sportive. Kjo ishte e duhura për mua dhe Roma ishte mundësia e duhur për mua. Nuk e kam menduar



aq shumë sepse Roma ka qenë gjithmonë prioriteti im", ka thënë Belotti. "E di që ka një lojtar të fortë si Abrahimi këtu,

por për mua është një stimul për ta përmirësuar veten dhe për të bërë më të mirën", ka shtuar Belotti.

Wall: Doja t'i jepja fund jetës dy vjet më parë

RALEIGH, 1 SHTATOR - "Në një moment të jetës sime kam menduar t'i jap fund gjithçkaje, duke u larguar nga kjo botë. Kjo ndodhi kur ishim në mes të pandemisë". Është kjo deklarata e trishtë e dhënë nga basketbollisti John Wall, një nga yjet e NBA-së dhe më të paguarit. Lojtari që këtë verë kaloi te Clippers, më tej shton: "Unë dëmtova Thembrenë e Akilit, mamaja ime u sëmurë dhe më pas ndërroi jetë. Po ashtu, edhe gjyshja ime. Isha me mamane në krah kur kryente kimioterapinë deri në frymën e saj të fundit. Kam fjetur për tri ditë me radhë në një divan". Ylli i NBA-së ka kaluar dy vjet të vështirë me fanellën e Houstonit dhe tashmë i kujton me trishtim ato çaste. "Nëse dola nga ajo situatë mund



t'ia dal mbanë ndaj çdo situatë tjetër në jetë", ka deklaruar John Wall. "Për mua, fakti që jam rikthyer është diçka e jashtëzakonshme. Tifozët kanë dëshirë të më shohin në fushë,

por edhe mbështetja e njerëzve ishte e madhe", ka thënë organizatori, që mori mbështetjen edhe të LeBron Jamesit: "Jam krenar për ty vëllai im".

SHKURT

Akanji paraqitet te City

Manuel Akanji është lojtari më i ri i Manchester Cityt. Lajmin e konfirmoi vetë klubi përmes një njoftimi në rrjetet sociale. Ky transferim u kushtoi "Qytetarëve" rreth 18 milionë euro. Lojtari ishte i kërkuar edhe nga disa skuadra të tjera në Premierë Ligë, por i zgjodhi kampionët anglezë si destinacion të ardhshëm.

Milani transferon Destin nga Barça

AC Milani ka bërë një goditje befasuese 24 orë para fundit të afatit kalimtar veror. Kampioni në fuqi i Italisë ka siguruar shërbimet e mbrojtësit të djathtë amerikan, Sergino Dest. Ky i fundit nuk ishte në planet e trajnerit Xavi Hernandez dhe Barcelona ka pranuar ofertën e gjigantit italian për huazimin e futbollistit. Ka qenë eksperti i tregut të transferimeve, Fabrizio Romano që ka zbuluar marrëveshjen e arritur mes dy klubeve. Dest do t'i bashkohet Milanit si huazim për një vit, me "Rossonerët" që kanë opsionin e blerjes për 20 milionë euro në verën e vitit 2023, por që nuk është e detyrueshme.

Kloppi e quan 'përgjigje të përkryer' fitoren ndaj Newcastle's

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, e ka quajtur "përgjigje të përkryer" fitoren ndaj Newcastle's, ku "The Reds" shënoi golin e fitores në minutën e 98 të lojës. "Në fund isha shumë i lumtur kur morëm aksionin e fundit dhe ajo që Mo Salah dhe Fabio bënë ishte absolutisht e jashtëzakonshme. Ishte përgjigja e përkryer ndaj asaj që kishte ndodhur. Më pëlqeu fitorja, por duhet të kishim luajtur më shumë futboll. Newcastle bëri shumë mirë me mënyrën se si na vuri nën presion", ka thënë Klopp, i cili pretendoi se nuk kishte parë asgjë, kur gjësende u hodhën nga bankina e Newcastle's në drejtim të stafit të Liverpoolit, kur po festonin për golin e dytë, shkruan "Guardian". "Nuk e pashë, sinqerisht. U ktheva në anën tjetër për të festuar dhe kur u ktheva u befasova", ka shtuar Klopp.

Silva: Jam i lumtur në City

Bernardo Silva nuk e ka ndër mend të lëvizë nga Manchester City, ani pse gjatë gjithë verës është lidhur me një kalim te Barcelona. 28-vjeçari është shprehur se është i lumtur në klubin anglez dhe në këtë mënyrë ia ka mbyllur dyert Barçës. "Nuk kam marrë oferta nga Spanja. Unë qëndroj në Manchester City. Jam i lumtur. Vendimi është marrë", ka thënë Silva për "RAC1".

Serena Williams kalon në rrethin e tretë të US Open

Serena Williams nuk e ka ndër mend të ndalet. Tenistja amerikane e ka shtyrë pensionimin dhe çdo ditë e më shumë po demonstroi se nuk ka

gabuar. Ish-tenistja numër 1 në botë ka impresionuar në rrethin e dytë të turneut të madh të tenisit, US Open, duke e mundur bartësen numër 2 në botë, Anett

Kontaveit. 41-vjeçarja momentalisht është e 605-ta në botë, por kjo nuk e pengoi që ta mundte estonezen 2-1 në sete, 6:7, 6:2 e 6:2. Në rrethin e tretë të

këtij turneu prestigjioz të tenisit, Serena do të ketë punë me australianen Ajla Tomljanovic, në meçin që do të luhet të premten. Williamsi ka paralajmëruar

pensionimin pas turneut US Open, të cilin synon ta fitojë për ta ngritur në 24 numrin e Grand Slamit, në një karrierë të jashtëzakonshme që e kishte.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Bazuar në nenin 79, 80 dhe nenin 81, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligji nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, Policia e Kosovës shpall:

KONKURSIN

Referenca: [07/1-01SAP-R/584/2022](#)

Për plotësimin e vendeve të punës

- Titulli i vendit të punës:** Automekanik- dhjetë (10) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për servisimin e rregullt të Automjeteve të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë dhe njofton mbikëqyrësin dhe përgjegjës për servisimin/riparimin e automjeteve të aksidentuara të PK-së.
- Përgjegjës për riparimin, mënjanimin e problemeve mekanike të automjeteve duke siguruar që të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë, njofton mbikëqyrësin, analizon dhe vlerëson faktorët më të shpeshtë të prishjeve të automjeteve.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjerë të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Të ruaj sekretin e institucionit, duke mos nxjerrë në opinionin publik informata që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kryen edhe detyra tjera që janë të ndërlidhura me këtë natyrë të punës sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

- Titulli i vendit të punës:** Autolimar- Pesë (5) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për riparimin të automjeteve të aksidentuara të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Përgjegjës për mënjanimin e dëmtimeve mekanike të karoseris së automjeteve duke siguruar që të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë dhe njofton mbikëqyrësin dhe analizon e bën identifikimin e pjesëve të dëmtuara që mund të riparohen.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura.
- Përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjerë të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Të ruaj sekretin e institucionit, duke mos nxjerrë në opinionin publik informata që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kryen edhe detyra tjera që janë të ndërlidhura me këtë natyrë të punës sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

- Titulli i vendit të punës:** Autoelektricit- Tri (3) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për riparimin dhe instalimin elektrik në automjetet e PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Përgjegjës për riparimet dhe instalimet elektrike të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezerve dhe njofton mbikëqyrësin për furnizim.
- Vlerëson dhe bënë identifikimin e pjesëve të dëmtuara që mund të riparohen.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e papërgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura.

- Përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjerë të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Kryen edhe pune tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

- Titulli i vendit të punës:** Teknik metalpunues (axhustator)- dhjetë (10) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimin e grilave, të dritareve, për vendosjen e tyre në Qendrat e Mbatjes, nëpër objektet e PK-së.
- Punimin e grilave të dritareve, për vendosjen e tyre në dhomat e dëshmimeve, në objektet e PK-së.
- Punimin e grilave të dyerve për vendosje në dhomat e dëshmimeve në objektet e PK-së.
- Riparimin të rrethojave të objekteve për shkaqe sigurie.
- Vendosjen e grilave metalike të objekteve në hapësirat me konfidencialitet të veçantë.
- Ndërrimin e dyerve metalike, në dhomat e dëshmimeve dhe qendrat e mbajtjes.
- Vendosjen e dyerve metalike në dhomat me konfidencialitet të veçantë.
- Vendosjen e bravave mbrojtëse, nëpër dyer metalike.
- Kryen detyra tjera sipas udhëzimeve të dhëna nga Udhëheqësi i Njësisë së Teknikëve.

Shkollimi dhe shkathësitë për të gjitha pozitat e kërkuara:

- Të posedoj diplomë të shkollës së mesme.
- Së paku 1 vit përvojë pune.
- Trajnim përkatës.
- Aftësi profesionale dhe motivuese.
- Posedim të standardeve të lartaetike.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup, në ambient multietnik.
- Të ketë shkathësi të dëshmuara të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Nivel të lartë të ndershmërisë dhe konfidencialitetit.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e Nëpunës administrativ dhe mbështetës janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë një rënë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës, dhe
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Formulari për aplikim;
- Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit dhe pas nënshkrimit nga aplikanti i bashkëngjitet aplikacionit;
- Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës të notifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- Certifikata /ekstraktin e lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumentet nga pika e dhe f duhet të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në intervistë. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë në ankesë. Informimi i kandidatëve lidhur me rezultatet do të publikohet në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data **31.08.2022** deri me **14.09.2022**.

Mënyra e aplikimit:

Formularët duhet t'i dorëzohen në Njësinë për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751 dhe 038 245 184.

"Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".



Republika Kosova
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
 Ministry of Internal Affairs
 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
 Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Na osnovu člana 79,80 i člana 81 stav 1. pod stava 2.2. Zakona br. 06/L-114 za Javne službenike, član 8 Zakona br. 03/L-212, o radu, Policija Kosova objavljuje:

KONKURS

Referencija: 07/ 1-01SAP-R/ 584/2022

Za popunjavanje radnih mesta

1. **Naziv radnog položaja:** Automehaničar- deset (10) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike / Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za redovno servisiranje Vozila PK-a, shodno planiranju i zahteva kako bise obezbedilo da sva vozila PK-a, budu funkcionalna.
- Identifikovanje potreba za rezervne delova i upoznavanje nadzornika i odgovornost za servisiranje/ opravku oštećenih vozila PK-a,
- Odgovoran za popravku, otklanjanje mehaničkih kvarova na vozilima, staranje o njihovoj uskladenosti sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikuje potrebe za rezervnim delovima, obaveštava nadzornika, analizira i procenjuje najčešće faktore kvarova vozila.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladenost sa odobrenim tehničkim standardima.
- Vodi računa o tome da svaka popravka vozila bude po porudžbini i iskazanim hitnim potrebama i odgovoran je za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama kako bi svaka popravka bila završena prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Da sačuva tajnost institucije, tako da ne daje u javnosti informacije a koje nisu u njegovu nadležnost.
- Obavlja i druge poslove koje su povezane sa njegovom prirodom poslova na zahtev nadzornika i kvalifikacije koje poseduje.

2. **Naziv radnog položaja:** Auto limar- Pet (5) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za opravku osećanih Vozila PK-a, u udesima, shodno planiranju i zahteva kao bise obezbedilo da sva vozila PK-a, budu funkcionalna.
- Odgovoran za popravku, otklanjanje mehaničkih kvarova na vozilima, staranje o njihovoj uskladenosti sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikovanje potreba za rezervne delova i upoznavanje nadzornika i analizira vrši identifikaciju rezervnih delova koje mogu da se popravljaju.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladenost sa odobrenim tehničkim standardima.
- Stara se za svaku opravku na vozilima da buzde prema redosledu i hitnim opravdanim potrebama.
- Odgovoran za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama tako da se svaka popravka završi prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Da sačuva tajnost institucije, tako da ne daje u javnosti informacije a koje nisu u njegovu nadležnost.
- Obavlja i druge poslove koji su u vezi sa ovom vrstom poslova po zahtevu rukovodioca i kvalifikacijama koje poseduje.

3. **Naziv radnog položaja:** Auto električar-Tri (3) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za opravku i električnu instalaciju u Vozilima PK-a, u udesima, shodno planiranju i zahteva kao bise obezbedilo da sva vozila PK-a, kako bi bila funkcionalna.
- Odgovoran za popravku i električnu instalaciju da su uskladeni sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikuje potrebe za rezervne delove i obaveštava nadzornika sa snabdevanje.
- Vrši procenu i identifikaciju oštećenih delova koje mogu da se poprave.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladenost sa odobrenim tehničkim standardima.

- Stara se za svaku opravku na vozilima da buzde prema redosledu i hitnim opravdanim potrebama.
- Odgovoran za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama tako da se svaka popravka završi prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadzornika i kvalifikacije koje poseduje.

4. **Naziv radnog položaja:** Tehničar metaloprerađivač (varioca-mašinbravar) - deset (10) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Rad rešetaka prozora, njihovo postavljanje u Centrima Zadržavanja, na objektima PK-a,
- Rad rešetaka prozora, njihovo postavljanje u Komorama dokaza, a objektima PK-a,
- Rad rešetaka vrata, njihovo postavljanje u Komorama dokaza, u objektima PK-a,
- Opravku ograda objekata iz bezbednosti razloga,
- Postavljanje metalnih rešetki objekata u prostore sa posebnom poverljivošću,
- Zamenu metalnih vrata, u komorama dokaza i centrima za zadržavanje,
- Postavljanje metalnih vrata u prostorijama sa posebnom poverljivošću,
- Postavljanje zaštitnih brava u prostorijama od posebne poverljivosti.
- Obavlja i druge poslove po nalogu Rukovodioca Tehničke Jedinice.

Obrazovanje i veštine za sve potrebne položaje:

- Da poseduje diplomu srednje škole
- Da ima najmanje 1 godinu, radnog iskustva,
- Odgovarajuću obuku
- Profesionalne i motivisane sposobnosti
- Posedovanje visokih etičkih standarda,
- Da je sposoban za rad u grupi, u multietničkom okruženju,
- Dokazane veštine pismene i usmene komunikacije,
- Visoki nivo poštenosti i poverljivosti

Opšti zahtevi za prijem Administrativnog Službenika i pomoćnika su:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je potpuno sposoban za rad;
- Da poznaje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je zdravstveno sposoban za obavljanje odgovarajućih poslova;
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za izvršavanje krivičnog dela;
- Da nema neku disciplinsku meru za razrešenje sa položaja javnog službenika, obustavljena po ovom zakonu.
- Da imaju nivo obrazovanja i radno iskustvo potrebno za odgovarajući položaju, kategoriju, klasu ili grupu; i
- Da uspešno položiti prijemne procedure, po ovom zakonu.

Potrebna dokumentacija za konkurisanje:

- FORMULARI za apliciranje;
- Izjava (u vezi sa usaglašenosti o istragama prošlosti) može se preuzeti sa ueb-stranice Policije Kosova www.kosovopolice.com gde se nalazi objavljivanje konkursu i nakon potpisivanja od strane aplikanta prilaže se aplikaciji;
- Kopija diplome o traženoj stručnoj spremi, dok za kandidate koji su školovanje završili u inostranstvu kopiju nostrifikovane diplome;
- Dokazi ostalih kvalifikacija, dokaz o radnim iskustvu;
- Sertifikat / Izvod rodnjeni;
- Potvrdu suda da nije kažnjavan i da nije pod istragom;
- Primerak lične karte ili važećeg pasoša;
- Jedna fotografija formata (5 x 5);
- Dokumenta iz tačke e i f moraju biti važeća i izdata posle datuma objavljivanja konkursa.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje:

Na osnovu navedenih zakonskih akata, sve prijave i pristigla dokumentacija biće pažljivo razmotrene i tokom pregleda, ukoliko se utvrdi da kandidat ne ispunjava kriterijume utvrdjene za prijavu i prijem u radni odnos, ili ako prijava sadrži lažne podatke, kandidat će biti odmah diskvalifikovan. Uspešni kandidati biće pozvani da učestvuju na intervjuisanje.

Ovi položaji podvrgavaju se procesu provere i mogu da se popunjavaju nakon uspešnog obavljanja postupka provere.

Na kraju izbornog procesa neizabrani kandidati imaju pravo žalbe.

Obaveštenje kandidata u vezi rezultata objaviće se na ueb-stanici Policije Kosova, na adresi www.kosovopolice.com, kod rubrike mogućnost zapošljavanja.

Datum početka i završetka konkursa:

Konkurs će biti otvoren 15 dana od **31.08.2022** do **14.09.2022** godine.

Način apliciranja

Obrasci se moraju dostaviti Jedinici za Regrutaciju i Selekciju, Nova Zgrada Administracije, GDP, Priština, lično ili poslati poštom na ovu adresu: **Policija Kosova, ul. "Luan Haradinaj", 10000 Priština, Jedinica za Regrutaciju i Selekciju, III-sprat kancelarija 54, svakog radnog dana od 09:00-15:00 do poslednjeg roka za konkurisanje.** Primljena dokumentacija neće se vratiti!

Zahtevi dostavljeni posle isteka roka neće se prihvatiti. Ne kompletirana dokumentacija može da se odbaci.

Obrasci za apliciranje su na raspolaganju na web stranici Policije Kosova www.kosovopolice.com gde se nalazi objavljivanje konkursa.

Brojevi za kontaktiranje: Za dodatne informacije možete pozvati na sledeće brojeve telefona za kontaktiranje: 038- 5080 lokal : 1002 /038-504504 lokal:1751 i 038 245 184.

"Policija Kosova služi celom narodu Kosova. "Policija Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građana Republike Kosova, i očekuje aplikacije od svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu"

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Syla Group" Sh.p.k. Skenderaj, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Klinikë të Poshtme, Skenderaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.09.2022 në ora 11:00 në Salla e takimeve në Hotel(Restorant) "Freskia" ne rrugën "Skenderbeu" (Skenderaj) – Klinikë e Poshtme, apo R102 (Drenas- Skenderaj-Klinikë e Epërme) do të organizohet debat publik nga Kompania "Syla Group" Sh.p.k. Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e betonit në Klinikë të Poshtme, Skenderaj.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9072254231?pwd=QjhTUE1yMVFCbTBLR3laU2xEQkx0Zz09>

Meeting ID: 907 225 4231

Passcode: N3hASu

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Alida Kalaveshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Rroni Rrahmani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, dhe certifikatën e maturës e Gjmnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Floriana Domgjoni nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "At Gjergj Fishta" Bishtazhin, KK Gjakovë. Nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Aldi Cërmjani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII të gjmnazit "Hajdar Dushi".
- ▶ Lumturie Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Blerim Sylaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Erëza Vokshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e e kl.I, II, III, IV e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ "Ideade" Sh.PK, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810070681.
- ▶ "Natyra" Sh.PK, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810548729.
- ▶ "A&A Coatings" Sh.P.K, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810548216.
- ▶ "Lami Project", shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr: 330172388.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues